



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

Dokument parlamentar

### PROCESVERBAL

Datë 11.11.2015, ora :10:00

#### **Drejton mbledhjen:**

**Oerd Bylykbashi – nënkryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Projektligji “Për ratifikimin e vendimit të Këshillit të Stabilizim - Asociimit, Bashkimi Evropian Shqipëri, 1/2015, i datës 11.5.2015, që zëvendëson Protokollin 4 të Marrëveshjes së Stabilizim–Asociimit, ndërmjet Komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare, nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë, nga ana tjetër, në lidhje me përkufizimin e konceptit “produkte origjinuese” dhe metodat e bashkëpunimit administrativ”.

#### **Marrin pjesë:**

Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Anila Agalliu, Ulsi Manja, Pandeli Majko, Eduard Halimi, Dashamir Peza, Mhill Fufi, Gent Strazimiri, Petrit Vasili, Arben Ristani, Vexhi Muçmataj, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj, Vasilika Hysi, Silva Caka.

#### **Mungojnë:**

Fatmir Xhafaj, Fatmir Mediu, Tom Doshi.

**Të ftuar:**

Gentian Elezi – zëvendësministër i Integritetit Europian

Ilirjan Xhezo – drejtor i Drejtorisë së Politikave Sektoriale në Ministrinë e Integritetit Europian

Altin Fuga - përgjegjës sektori në Drejtorinë e Politikave në Ministrinë e Integritetit Europian

Zamira Xhepa - specialiste në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizimit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

## HAPET MBLEDHJA

**Oerd Bylykbashi** – Mirëmëngjesi!

Të nderuar kolegë, fillojmë mbledhjen e komisionit.

Në rendin e ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e vendimit të Këshillit të Stabilizim- Asociimit, Bashkimi European Shqipëri, 1/2015, i datës 11.05.2015, që zëvendëson Protokollin 4 të Marrëveshjes së Stabilizim–Asociimit, ndërmjet Komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare, nga njëra anë, dhe Republikës së Shqipërisë, nga ana tjetër, në lidhje me përkufizimin e konceptit “produkte origjinuese” dhe metodat e bashkëpunimit administrativ”.

Relator i komisionit për këtë çështje është zoti Pandeli Majko.

Të ftuar nga Ministria e Integritimit European kemi zotin Gentian Elezi, zëvendësministër i Integritimit European. Nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes shoh se nuk ka pjesëmarrës, siç ishte parashikuar këtu.

Zoti zëvendësministër, ju lutem, një prezantim të shkurtër në lidhje me projektligjin që keni sjellë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

**Gentian Elezi** – Mirëdita!

Faleminderit, zoti Bylykbashi!

Sot Këshilli i Ministrave paraqet këtë projektligj për një amendim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, që vjen si detyrim i nënshkrimit të konventës dhe pjesëmarrjes në Konventën Europiane Rajonale për Komulimin Diagonal për këtë ndryshim që i bëhet aspektit tregtar të marrëdhënieve të Shqipërisë jo vetëm me Bashkimin European, por edhe me vende të tjera, si ato EFTA dhe më gjerë, për sa i përket përkufizimit të produkteve të origjinës.

Projektligji i Këshillit të Ministrave synon pikërisht ratifikimin e vendimit të Këshillit të Stabilizim-Asociimit të muajit maj të këtij viti, për zëvendësimin e Protokollit nr. 4 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Bashkimit European dhe Republikës së Shqipërisë dhe për përkufizimin e konceptit “produkte origjinuese” dhe metodat e bashkëpunimit administrativ.

Këto ndryshime natyrisht që do të sjellin përfitime ekonomike për Shqipërinë, sepse të gjitha vendet, që janë palë e kësaj konvente, e cila zëvendëson këtë protokoll, do të mundën që të importojnë produkte parësore, pra lëndë të parë, ta përpunojnë dhe më pas ta eksportojnë, duke e konsideruar produktin origjinues në vendin përkatës, që në këtë rast është Shqipëria.

Një avantazh tjetër i harmonizimit që bëhet është edhe përfshirja në skemën e komulimit diagonal të vendeve të tjera, vendet anëtare të EFTA, pra zgjerohet gama e hapësirës tregtare të Shqipërisë, duke përdorur pikërisht mekanizmin e akumulimit diagonal.

Pra, ky është ndryshimi, zëvendësimi i protokollit në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me një përditësim, duke futur referencën ndaj konventës, të cilën e kanë nënshkruar të gjitha vendet.

Faleminderit!

**Oerd Bylykbashi** – Faleminderit, zoti Elezi!

Fjalën e ka zoti Majko, si relator i komisionit.

**Pandeli Majko** – Kam përshtypjen se është një ndër rastet e rralla ku marrëveshja është tepër teknike, standarde dhe vetë titulli flet për të gjitha ato që shpjegoi zoti zëvendësministër.

I ftoj kolegët që ta votojmë së bashku.

**Oerd Bylykbashi** – Faleminderit, zoti Majko!

A ka pyetje nga anëtarët e komisionit rreth këtij projektligji? Nuk ka.

Diskutime? Nuk ka.

Votojmë në parim projektligjin.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Fillojmë shqyrtimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Votojmë projektligjin në tërësi.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji.

Kjo çështje e mbyll rendin e ditës për sot në mbledhjen e komisionit.

Faleminderit, zoti Elezi!

Faleminderit të gjithëve!

## **MBLEDHJA MBYLLET**

